



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Datë: 27.03.2026

PROCES-VERBAL

Këshilli Bashkaik Kamëz i mbledhur sot, në dt. 27.03.2026, në orën 16:00, në mbledhjen e radhës të muajit Mars 2026 në sallën e Këshillit Bashkiak, Bashkia Kamëz. Të pranishëm në mbledhje janë 24 anëtar të Këshillit, përfaqësues nga administrata e Bashkisë, qytetar. Mbledhja mbahet nga Kryetari i Këshilli Bashkiak z.Hysen Koldashi i cili hap mbledhjen me fjalët përshëndetëse.

Kr. Hysen Koldashi: Sipas njoftimit nga sekretaria mbi bazë të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe bazuar në rregulloren e Këshillit Bashkiak 33 datë 21.03.2024; Neni 81 pika 1, sot zhvillohet mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak.

Kr. Hysen Koldashi: Përpara se ta fillojmë, i kalojmë fjalën sekretarisë për prezencën. Ju lutem, sekretaria.

- Sekretaria konfirmon pjesëmarrjen e Këshilltarëve.
- **Kr. Hysen Koldashi:** Paraprakisht hedhim në votim Proces-verbalin e mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak. E hedhim në votim. 22-vota Pro, 0-Kundra, 0-Abstenim.
- **Kr. Hysen Koldashi:** Faleminderit! Atëherë, me rendin e ditës jeni njohur, e keni të printuar në tavolinën tuaj, si më poshtë vijon:
 -
 - 1. Projekt-Vendim Nr.17 datë 27.02.2026 për: “Miratimin e limiteve të PBA për vitet 2027-2028-2029”.
 - 2. Projekt-Vendim Nr.18 datë 03.03.2026 për: “Transferimin kapital të vlerës së aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara “fadromë me kove” në shoqërinë ujësjellës kanalizime SH.A Kamëz”.
 - 3. Projekt-Vendim Nr.19 datë 17.03.2026 për: “Dhënie ndihme financiare për diegie banese”.
 - 4. Projekt-Vendim Nr.22 datë 19.03.2026 për: “Mbështetjen financiare të shoqatës sportive “Futboll Triumph Academy” për realizimin e turneut ndërkombëtar të futbollit, “AF TRIUMPH CUP EVENTS 2026”.
 - 5. Projekt-Vendim Nr.23 datë 25.03.2026 për: “Miratimin e planit vendor të mbrojtjes së fëmijëve 2026-2030”.
 - 6. Projekt-Vendim Nr.20 datë 19.03.2026 për: “Dhënie ndihme ekonomike për familjet në nevojë nga buxheti i bashkisë dhe nga fondi 6% i bllok-ndihmës ekonomike”.
 - 7. Projekt-Vendim Nr.21 datë 19.03.2026 për: “Dhënie ndihme ekonomike për familje në nevojë nga buxheti i bashkisë”.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

8. Ndryshim emërtimi të disa rrugëve në territorin e Bashkisë Kamëz.
9. Të ndryshme.

Kr. Hysen Koldashi: Pyetje-Diskutime: S'ka. E hedhim në votim rendin e ditës.22-Pro; 0-Kundër, 0-Abstenim. Miratohet.

Kr. Hysen Koldashi: Atëherë vazhdojmë sipas radhës me projektvendimet. Projekt-Vendim Nr.17 datë 27.02.2026 për: “Miratimin e limiteve të PBA për vitet 2027-2028-2029”.

Kr. Hysen Koldashi: Do procedojmë me pyetje nga këshilltarët. Kush ka pyetje nga këshilltarët? Nëse s'ka pyetje, ka kush paqartësi, kemi drejtoreshën prezente. Pyetje-Diskutime: S'ka. E hedhim në votim 21-Pro; 1-Kundër, 0-Abstenim. Miratohet.

Kr. Hysen Koldashi: Vazhdojmë me projektvendimin tjetër. Projektvendim numër 18, datë 03.03.2026, “Transferimin kapital të vlerës së aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara “fadromë me kove” në shoqërinë ujësjellës kanalizime SH.A Kamëz”. Pyetje -diskutime?

Alfred Halilaj Keshilltar merr fjalën: Unë Kisha një pyetje. Ku ishin deri më tani këto mjete?

Kr. Hysen Koldashi: I ka patur Bashkia Kamëz i kalon shoqërisë aksionere të ujësjellësit. E hedhim votim.

Kr. Hysen Koldashi: Pyetje-Diskutime të tjera.S'ka. E hedhim në votim .22-vota Pro; 0-Kundër, 0-Abstenim. Miratohet.

Kr. Hysen Koldashi: Viojmë me Projektvendim numër 19, datë 17.03.2026 “Dhënie ndihme financiare për diegie banese”, Këshilltarët, kush ka pyetje? Nuk ka. Ndonjë paqartësi?

Kr. Hysen Koldashi: E hedhim në votim? 22-Pro; 0-Kundër, 0-Abstenim. Miratohet.

Kr. Hysen Koldashi: Projek-vendimi i radhës. Projekt-vendim numër 22 datë 19.03.2026. “Mbështetjen financiare të shoqatës sportive “Futboll Triumph Academy”, për realizimin e turneut ndërkombëtar të futbollit, “AF TRIUMPH CUP EVENTS 2026”. Kemi drejtoreshën. Kjo mendoj që do shpjegim. Pra, drejtoresha fjala për ju. Pastaj, nëse ka pyetje nga këshilltarët, i bëjmë dhe përgjigje specifike për secilën pyetje.

Aferdita Zefi-Dr.Arsimit Rinisë dhe Sportit Bashkia Kamëz. Përshëndetje të gjithëve. Atëherë, pranë Bashkisë Kamëz, Shoqata Sportive “Futboll Triumf Akademi”, ka paraqitur një kërkesë për të organizuar një kampionat ku do marrin pjesë 80 ekipe futbollit të ndryshme, të kategorive të ndryshme, dhe do të jenë ekipet, nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut, Mal i Zi dhe Lugina e Preshevës. Ky kompeticion do të organizohet në datat 5, 6, 7 Prill 2026 në terrenet sportive të Bashkisë Kamës. Dhe na duhet një mbështetje financiare, në shumën e



**REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

përcaktuar në projektvendim. Do të jetë një organizim efektiv për të promovuar edhe organizimin e veprimtarive sportive dhe promovimin e rinisë së Kamës.

Kr. Hysen Koldashi: Këshilltar, ka pyetje? Fjala për ju z. Halilaj

-Futet në mbledhje Këshilltari z.Dritan Bresa

Alfred Halilaj Këshilltar: Si ka mundësi që ne nuk kemi mbështetur ekipin e qytetit dhe mbështesim një shoqatë e cila merr përsipër të organizojë një kompeticion me lekët tona një aktivitet, më duket absurd. Do doja të isha pro por e kam të pamundur, kur këto lekë mund të shkojnë për ekipet tona.

Kr. Hysen Koldashi: Znj. drejtoresha do jua jap unë përgjigjen. Nuk ishte pyetje specifike. Nëse ka pyetje që ka të bëjë me bazën ligjore te projekt vendimit, jemi dakord, pastaj nëse dikujt nuk i pëlqen gjëja voton kundër dhe jep shpjegimin e votës kundër, arsyeja sepse.. Pyetje të cilat janë në kundërshtim me bazën ligjore apo jo në kopetencë të këshillit, okej.

Kr. Hysen Koldashi: Ka kush pyetje tjeter? Po z.Shehu fjala për ju.

Munir Shehu Këshilltar . Përshëndetje. Kamza a përfaqësohet në këtë orgaznizim?

Aferdita Zefi-Dr.Arsimit Rinisë dhe Sportit Bashkia Kamëz: Po patjetër, ekipi i Kamzës bën pjesë është pikërisht Triumf Academy. Ky është një buxhet i parashikuar, te buxheti që kemi miratuar. Ne donim tju informonim që do të zhvillohet ky kompeticion.

Alfred Halilaj Këshilltar: Kjo “Triumf Academy”, është ajo që ne mbështetem? Pra, këtu praktikisht këtu kemi një konflikt të qartë interesi. Ka konflikt interesi?

-Faik Basha i bashkohet mbledhjes së këshillit.

Xhuljana Elezaj Këshilltare: Nuk ke konflikt interesi pasi kur e kemi miratuar. Andi Lila ka kërkuar që të krijojë një ekip futbollit në Bashkinë Kamëz, pikërisht.

Alfred Halilaj Këshilltar: A kemi neve një kundërshti ligjore, pasi i kemi dhënë të drejtën kësaj shoqate të formojë ekipin..dmth a jeni në kontraditë?

Kr. Hysen Koldashi: Ja të ta jap unë përgjigjen shumë të qartë. Kemi marrë vendim këtu në këshill, por ju nuk keni qenë present, kemi thënë që shoqata nuk merr asnjë fond nga Bashkia Kamëz për stërvitje.

Kr. Hysen Koldashi: E hedhim në votim? 21-Pro; 2-Kundër, 1-Abstenim. Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Kr. Hysen Koldashi: Vazhdojmë me projektvendimin e radhës. Projekt-Vendim Nr.23 datë 25.03.2026 për: “Miratimin e planit vendor të mbrojtjes së fëmijëve 2026-2030”.

Ka kush nga këshilltarët pa qartësi? Ka kush pyetje? Bazuar në relacionin nëse ka pa qartësi, nuk ka.

Koldashi: E hedhim në votim 24-Pro; 0-Kundër, 0-Abstenim. Miratohet.

Kr. Hysen Koldashi: Vazhdojmë me projektvendimin e radhës. Projekt-Vendim Nr.20 datë 19.03.2026 për: “Dhënie ndihme ekonomike për familjet në nevojë nga buxheti i bashkisë dhe nga fondi 6% i bllok-ndihmës ekonomike”.

Ka kush ndonjë pyetje nga këshilltarët? Nuk ka. Diskutim, apo ndonjë paqartësi? Ska.

Koldashi: E hedhim në votim. 24-Pro; 0-Kundër, 0-Abstenim. Miratohet.

Kr. Hysen Koldashi Projekt-Vendim Nr.21 datë 19.03.2026 për: “Dhënie ndihme ekonomike për familje në nevojë nga buxheti i bashkisë”. Ka kush pa qartësi? Pyetje? Nuk ka.

Kr. Hysen Koldashi: E hedhim në votim . 24-Pro; 0-Kundër, 0-Abstenim. Miratohet.

Kr. Hysen Koldashi: Dhe pika e fundit për të kaluar tek të ndryshmet, kemi të bëjmë me ndryshimin e dy segmenteve rrugësh në Bathore. Një segment që ka të bëjë me rrugë pa emër në Lagjen.5 Bathore. E keni edhe në aty në tavolinën tuaj. Është rrugë pa emër, kërkohet nga banorët ti vendoset emërtimi, “Abdi Kryekurti”. Kemi përfaqësues të komisionit, po? Keni nevojë për shpjegime apo do ta kalojmë? S'ka nevojë.

-Faik Basha Këshilltar: Kush ka qene ky Abdi Kryekurti sa për informacion?

Kr. Hysen Koldashi: E keni të relacioni, besoj e keni marrë, e keni në tavolinën aty edhe kërkesa, me gjithë relacionin .

Kr. Hysen Koldashi: E hedhim në votim? 24-Pro; 0-Kundër, 0-Abstenim. Miratohet.

Kr. Hysen Koldashi: Viojmë me një ndryshim rruge. Këtë dua ta sqaroj pak, në mbledhjen paraardhëse të Këshillit Bashkiak kemi ngritur një komision i cili do të merret me verifikimet në terren, ku në territorin e Bashkisë Kamëz nuk duhet të ketë dy emra rrugësh apo institucionesh.. Dhe është filluar të punohet me këtë dhe nga emri, “Ibrahim Basha”, kërkohet të vendoset “Zylfi Sulmataj”, është segment rruge tek Lagja 4 në Bathore, te kryqëzimi përballë Belbës. Ka kush pyetje, paqartësi? S'ka.

Kr. Hysen Koldashi: E hedhim në votim 23-Pro; 1-Kundër, 0-Abstenim. Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ



Faik Basha Këshilltar merr fjalën për shpjegimin e votës kundër: Nuk e di kush e ka bërë propozimin, Unë në atë lagje banoj, por gjithsesi rrugë me dy emra ka rrugë shkolla, objekte, nuk është e vetmja rrugë në Shqipëri kjo që mban emrin e dëshmorit dhe një institucion tjetër që mban.

Kr. Hysen Koldashi: Ke shumë të drejtë, në mbledhjen e kaluar kemi marrë një vendim, s'keni qenë prezent ju, prandaj dhe po veprohet edhe për institucionet edhe për rrugët. Dhe është votuar.

Kr. Hysen Koldashi: Tani u miratua kjo dhe kalojmë tek pika e fundit të ndryshme.

Kr. Hysen Koldashi: Kush e do fjalën? Kemi një kthim përgjigje nga një kërkesë e bërë në mbledhjen e kaluar nga zj. Xhuljana Elezaj dhe përgjigjen do ta marrësh me shkrim nga sekretaria për gjithçka keni kërkuar në mbledhjen paraardhëse. Ka ardhur nga drejtorja përkatëse.

Kr. Hysen Koldashi: të ndryshme. Diskutimet të tjera? Fjala për ju z. Shehu.

Munir Shehu Këshilltar: Jo, urdhëro. Ne parë dy muajve, a tre muajve kemi miratuam ngritjen e strehëzës për qentë e rrugëve. Deri më tani nuk është marrë asnjë masë, dhe qentë mbeten një problem i madh për banorët. Sa kohë i duhet Bashkisë të gjejë një zgjidhje për mbledhjen e qenve të futen për strehim te strehëza.? Pasi projekti ka qenë gati dhe kur do të merret për zbatimin e projektit.

Kr. Hysen Koldashi: Sekretaria patjetër që e mban shënim dhe do jua kthejmë përgjigjen para mbledhjes së radhës. Nëse s'është e mundur. Përgjigje korrekte do të marrësh me shkrim nga drejtorja përkatëse.

Munir Shehu këshilltar merr fjalën: Tek shkolla e Bathores, fëmijët po rrezikohen nga shëndeti i rrugës, nga prania e qenve. Më kupto? Edhe familjarët po ashtu. Të shihet jo vetëm në Bathore por në të gjithë territorin e Bashkisë Kamëz.

Kr. Hysen Koldashi: Je shumë i qartë për pyetjet konkrete dhe direkte, përgjigjen mund të japim me shkrim nga drejtorja përkatëse. Këshilltarë të tjerë? Nuk ka.

Kr. Hysen Koldashi: Atëherë mbledhja deklarohet e mbyllur. Faleminderit për kontributin tuaj. Mbledhja e radhës njoftohet nga sekretaria.

Sekretar

Nexhmije Topi